



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 9.2.2022, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin të vitit 1957”.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Antoneta Dhima, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Luan Duzha, Ilirian Pendavinji, Ervin Salianji, Flamur Noka, Enkelejd Alibeaj, Kasem Mahmutaj, Isuf Çelaj, Klevis Xhoxhi dhe Alban Xhelili.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj, Vullnet Sinaj, Bardhyl Kollçaku, Toni Gogu, Ferdinand Xhaferraj, Lindita Metaliaj, Agron Çela dhe Luan Baçi.

Të ftuar:

Adea Pirdeni – Zëvendësministre e Drejtësisë

Besmir Beja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço – Mirëmëngjesi!

Çelimi seancën e Komisionit të Sigurisë Kombëtare me rend dite projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin, vitit 1957”.

Të ftuar nga Ministria e Drejtësisë kemi zonjën Adea Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë dhe zotin Besmir Beja, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit.

Fjala është për ju, zonja Zëvendësministre, për të paraqitur në mënyrë të përmbledhur projektligjin, më pas fjala do të jetë për relatorin, për të vazhduar pastaj me pyetje dhe diskutime.

Faleminderit!

Adea Pirdeni – Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot paraqitet për shqyrtim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin, viti 1957”.

Kjo marrëveshje synon të intensifikojë nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, konkretisht përmes lehtësimit të procedurave të ekstradimit të shtetasve nëpërmjet të dyja vendeve.

Sjellim në vëmendjen e anëtarëve të nderuar të këtij komisioni se Konventa Europiane për Ekstradimin, e ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998, “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të dy protokolleve shtesë” parashikon shprehimisht në nenin 28 të saj: “Palët nënshkruese të kësaj konvente mund të nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, me qëllim plotësimin e parashikimeve të kësaj konvente dhe lehtësimin e zbatimit të saj”.

Mbi këtë bazë, projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje parashikon se palët bien dakord të ekstradojnë reciprokisht shtetasit e tyre, me qëllim ekzekutimin e një dënimi ose zbatimin e një mase sigurimi për kryerjen e veprave penale, në përputhje me dispozitat e Konventës Europiane për Ekstradimin.

Në nenin 6, pika 1, shkronja “a” të kësaj konvente parashikohet shprehimisht se çdo palë ka të drejtë të refuzojë ekstradimin e shtetasve të saj. Ndërkohë, në nenin 2 të ligjit nr. 8322, datë 02.04.1998, për ratifikimin e konventës në fjalë, parashikohet se lidhur me nenin 6, pika 1, shkronja “a”, pala shqiptare refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjen ndërkombëtare, ku Republika Shqipëria është palë, duke i hapur kështu rrugë mundësisë së ekstradimit të shtetasve shqiptarë, si dhe ekstradimit të shtetasve të vendeve të tjera drejt Shqipërisë, nëse parashikohet shprehimisht në një marrëveshje.

Më konkretisht, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje mundësohet ekstradimi i shtetasve spanjollë në Shqipëri dhe anasjelltas. Në këtë mënyrë synohet ruajtja dhe forcimi i lidhjeve ndërmjet vendeve dhe sistemeve të drejtësisë të të dyja vendeve, si dhe përmirësimi i zbatimit në praktikë i institutit të ekstradimit, sigurisht me qëllimin e dorëzimit reciprok të autorëve të veprave penale ose personave kundrejt të cilëve ushtrohet ndjekja penale ose ndaj të cilëve do të zbatohet një masë sigurimi. Kjo marrëveshje përbën një garanci të shtuar për marrëdhëniet juridiksionale me jashtë në fushën penale me Spanjën, duke parashikuar lejimin e ekstradimit të shtetasve të saj për secilin nga shtetet palë në këtë marrëveshje.

Kjo marrëveshje ka kaluar nëpërmjet të gjitha fazave të parashikuara nga legjislacioni “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Marrëveshja është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave në datën 29.09.2021 dhe në vijim të miratimit në parim marrëveshja është nënshkruar në datë 04.12.2021 nga kryeministrat e të dyja vendeve.

Kjo marrëveshje nuk parashikon nevoja buxhetore shtesë, pasi përcakton procedurat që ndiqen gjatë një kërkesë për ekstradim. Kostot eventuale të procedurës së ekstradimit do të përballohen brenda tavanëve buxhetore të miratuara për institucionet, të cilat janë të përfshira në procesin e ekstradimit.

Sipas parashikimit të nenit 24 të Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin, secila prej palëve mbulon çdo shpenzim që kryhet në territorin e palës së kërkuar për shkak të një kërkesë për ekstradim dhe, natyrisht, shpenzimet e transitit paguhen nga pala kërkuese. Në këtë fazë është e vështirë që të parashikohet apriori tërësia e kostove të domosdoshme dhe të nevojshme që duhet të mbulojnë institucionet e përfshira në këtë proces, përfshirë këtu Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, gjykatat dhe institucionet e tjera ligjzbatuese.

Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror për zbatimin e Konventës Europine për Ekstradimin dhe marrëveshjeve dypalëshe për ekstradimin, ka shqyrtuar një numër të

konsiderueshëm kërkesash për bashkëpunim gjyqësor në fushën penale nëpërmjet Spanjës. Ne kemi paraqitur dhe do t'ua vëmë në dispozicion anëtarëve të këtij komisioni edhe shifrat konkrete, të dhënat sasiore të nxjerra nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë, në mënyrë që të shikohet edhe fluksi i kërkesave që janë paraqitur ose që ka pasur me Spanjën.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeve ne synojmë t'i thellojmë më tej përpjekjet tona në kuadër të luftës kundër krimit transnacional në përgjithësi.

Në përfundim të kësaj ekspozite mbi procedurën e ndjekur në përmbajtjen e marrëveshjes, jemi në dispozicion të anëtarëve të këtij komisioni për çdolloj pyetje ose koment që mund të kenë.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit!

Fjalën e ka relatorja, zonja Pranvera Resulaj.

Pranvera Resulaj – Faleminderit!

Për të mos përsëritur në detaje atë çka përfaqësuesja e ministrisë prezantoi, dua t'u them të gjithë kolegëve dhe të gjithë atyre që na dëgjojnë se projektligji vjen në Komisionin e Sigurisë, si komision për dhënie mendimi. Ky projektligj vjen i propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe mbështetet në bazën ligjore, nenin 81, pika 1, dhe nenin 100 të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ashtu sikundër edhe marrëveshjet e tjera të ekstradimit, edhe qëllimi i këtij projektligji është për të përmirësuar procedurat e ekstradimit për të gjithë autorët e veprave penale, të cilët vuajnë dënimet në vendet respektive. Sigurisht, ashtu sikundër përfaqësuesja e ministrisë në mënyrë të detajuar dhe shteruese tha, në ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin të vitit 1957 Shqipëria ka deklaruar, siç e parashikon edhe dispozita e nenit 6, pika 1, ka deklaruar se refuzon ekstradimin e shtetasve të saj, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare mes shteteve, ku Shqipëria është palë.

Më 4 tetor 2021 kemi marrëveshjen me qeverisë shqiptare dhe Mbretërisë së Spanjës, në të cilën janë parashikuar të gjitha kushtet e ekstradimit të personave që vuajnë dënimin në shtetet respective sikurse e thashë.

Në këtë marrëveshje, e cila përmbledhet në 5 nene kryesore, janë parashikuar kushtet e ekstradimit, pra se cilat do të jenë, dhe me sa kemi parë shtetësia nuk është kriter pengues për

ekstradimin e personave të dënuar, gjithashtu këtu parashikohen, në nenin 2, kanalet e komunikimit, vazhdon me kushtet e zbatimit të përkohshëm apo afatet në të cilat vepron kjo marrëveshje. Këtu duhet të kemi parasysh se marrëveshja nuk zbatohet për kërkesa të ekstradimit të kryera para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, por në të njëjtën kohë për të gjitha kërkesat, të cilat janë kryer gjatë kohës kur marrëveshja ka qenë në fuqi dhe në rast se kjo marrëveshje e ndërpret fuqinë e saj, këto kërkesa do të vazhdojnë të trajtohen me fuqinë e kësaj marrëveshje deri në 6 muaj pas përfundimit të veprimit të saj.

Gjithashtu, hyn në fuqi data e njoftimit mbi përfundimin e procedurave të brendshme nga palët dhe merr parasysh momentin e ndërprerjes, mund të ndërpritet nga të dyja palët, duke u njoftuar nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Për sa i përket çështjes që diskutojmë gjithmonë, në përfundim të një aktmarrëveshje, ose të çdo marrëveshje ratifikimi, janë edhe kostoja financiare që ajo ka. Sikurse edhe përfaqësuesja tha, në fakt nuk mund të themi që kjo marrëveshje nuk ka kosto financiare, sepse çdo marrëveshje është e shoqëruar me kosto financiare, por nuk vjen e detajuar për shkak të pamundësisë për ta analizuar në detaje, sepse varet rast pas rasti dhe varet nga numri i personave që vuajnë dënimet respektive.

Për të mos u zgjatur, do t'u lë hapësirë edhe kolegëve që të bëjnë pyetje për rastet e kërkesave, për numrin e të dënuarve e të tjera.

Në përfundim, ftoj komisionin që ta miratojë këtë marrëveshje ratifikimi për ta bërë më eficiente ekstradimin e të dënuarve nga vendet respektive.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Resulaj!

Unë dua të falënderoj, ta mbështes dhe ta inkurajoj Ministrinë e Drejtësisë për marrëveshjet e tjera në lidhje me ekstradimin, pasi, në dijeninë time, ne kemi disa marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Italinë, Kosovën, Maqedoninë dhe disa vende të tjera të Europës Lindore, nëse nuk gaboj, dhe dua që të kemi edhe marrëveshje të tjera.

Ajo që më bën përshtypje në këtë marrëveshje është se më duket se është një marrëveshje inovative, sepse është vetëm me 5 nene, ndryshe nga marrëveshjet e tjera të kaluara më parë. Kjo është risi, është mentalitet i ri në Ministrinë e Drejtësisë dhe do të vazhdojë me këtë trend?

Faleminderit!

Adea Pirdeni – Faleminderit, për pyetjen, zoti kryetar!

Në fakt, kjo marrëveshje, sikurse edhe titullohet, është një plotësim i Konventës Europiane i Këshillit të Europës për ekstradimin, që do të thotë se termat e përgjithshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale për ekstradimin janë parashikuar në konventë. Praktikisht të dyja palët marrin përsipër të zbatojnë dispozitat e konventës dhe vetëm për pjesën që ka të bëjë me ekstradimin e shtetasve nga secili vend zbatohet kjo marrëveshje. Pra, është një marrëveshje plotësuese dhe kjo është dhe arsyeja përse është më e reduktuar në përmbajtje.

Nasip Naço – Po, zoti Salianji.

Ervin Salianji – Faleminderit!

U bënë disa raste që vijnë marrëveshje të kërkuara nga shtetet e Bashkimit European për ekstradimin. Pra, e gjitha kjo në thelb bëhet nga rritja e kriminalitetit qoftë në Shqipëri, qoftë të shtetasve shqiptarë jashtë Shqipërisë. Kjo marrëveshje është kërkuar nga Spanja apo nga Shqipëria?

E dyta, përse ka lindur nevoja për këtë marrëveshje plotësuese? A ka pasur kërkesa nga Spanja, të cilat janë refuzuar nga Shqipëria?

Nëse kemi të dhëna sa shtetas shqiptarë, në dijeninë tuaj, si Ministri e Drejtësisë, janë kërkuar apo kërkohen të ekstradohen nga Spanja? A ka pasur refuzim apo mbrojtje nga qeveria shqiptare të personave që kanë kryer vepra penale në territorin e Spanjës dhe ka lindur nevoja që të nënshkruhet kjo marrëveshje, të cilën, me sa e pamë edhe në relacion, edhe në projektligjin e propozuar, është firmosur si marrëveshje për të kaluar në vizitën e Kryeministrit në Spanjë? Pra, arsyeja përse është thirrur në Spanjë me sa duket është edhe kjo.

A ka pasur kërkesa që i janë refuzuar qeverisë shqiptare për shtetas spanjollë që kanë kryer krime? Kjo për të kuptuar nëse ka të bëjë me ndonjë kërkesë të qeverisë shqiptare apo ka hasur në probleme nga qeveria e Spanjës, apo është thjeshtë shqetësim i qeverisë së Spanjës, ashtu si i çdo vendi në Bashkimit European, për fat të keq, për shkak të rritjes së kriminalitetit në Shqipëri.

Faleminderit!

Adea Pirdeni – Faleminderit, për pyetjet!

Kjo marrëveshje, sikurse e kemi thënë edhe në mbledhjet e tjera të Komisionit të Sigurisë, është e negociuar gjatë vitit të shkuar. Gjithashtu, vitin e shkuar është negociuar edhe një tjetër marrëveshje e ratifikuar tashmë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për transferimin e të dënuarve, jo për ekstradimin.

Kjo marrëveshje vjen në vazhden e një sërë përpjekjesh të qeverisë shqiptare, veçanërisht Ministrisë së Drejtësisë, për të koordinuar të gjitha përpjekjet me vendet e Bashkimit Europian dhe vendet e tjera të interesuara, në kuadër të luftës kundër krimit transnacional. Kjo do të thotë se është një marrëveshje reciproke me interes dypalësh, sepse të dyja shtetet janë të interesuara për të ekstraduar shtetasit e një vendi ndaj një vendi tjetër nëse ato kanë kryer një vepër penale në territorin e tyre.

Kjo marrëveshje është kërkuar nga pala spanjolle, sigurisht qeveria shqiptare është e hapur për t'u angazhuar fuqimisht në bashkëpunimin transnacional, për më tepër kur ky lloj bashkëpunimi është reciprok. Kjo do të thotë që shtetasit spanjollë mund të ekstradohen nga Spanja në Shqipëri dhe shtetasit shqiptarë nga Shqipëria drejt Spanjës. Pra, ka një interes të përbashkët në luftën kundër krimit në këtë rast...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është kërkuar nga pala spanjolle, por kjo nuk do të thotë që Republika e Shqipërisë nuk ka një interes të barabartë për të luftuar krimin përmes kësaj marrëveshje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, i kam mbajtur shënim, por nuk kisha mbaruar.

Për sa i përket pyetjes për numrin e kërkesave për ekstradim, ne kemi paraqitur një pasqyrë që do t'ua vëmë në dispozicion anëtarëve të këtij komisioni, ua kemi vënë në dispozicion edhe anëtarëve të Komisionit të Ligjeve, ku përmbliidhen të gjitha kërkesat për ekstradim të ardhura nga Spanja që nga viti 2017 dhe deri në vitin 2021. Në total numri i kërkesave për ekstradim të ardhura nga Spanja është 25. Natyra e veprave penale për të cilat kërkohet ekstradimi, përgjithësisht ka të bëjë me prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike, pastrimin e produkteve të veprës penale dhe vepra penale të kësaj natyre.

Gjithashtu, pala shqiptare ka bërë tre kërkesa për ekstradim që kundrejt palës spanjolle, të cilat kanë të bëjnë me vepra penale të trafikimit të lëndëve narkotik, të vjedhjeve me dhunë ose ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit. Pra, numri total i kërkesave të ardhura nga Spanja është 25 dhe numri total i kërkesave të dërguara nga pala shqiptare drejt Spanjës është 3, nga viti 2017 deri në vitin 2021. Ky është numri i kërkesave

Ervin Saliajani – Bëhet fjalë për shtetas spanjollë?

Adea Pirdeni – Bëhet fjalë për kërkesa të ardhura nga autoritetet spanjolle, jo domosdoshmërisht për shtetas spanjollë, por edhe për shtetas shqiptarë.

Nasip Naço – Po kërkesat nga Ministria e Drejtësisë në drejtim të autoriteteve gjyqësore spanjolle...

Adea Pirdeni – Po, kërkesa për ekstradimi.

Nasip Naço – ... dhe rastet për shtetas spanjoll apo shqiptar.

Adea Pirdeni – Një pjesë e tyre janë shtetas spanjollë dhe një pjesë nuk janë shtetas spanjoll.

(Ndërhyje pa mikrofon)

Po pra mund të jenë shqiptar ose spanjoll sipas rastit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për këto tre raste mund t'jua vë në dispozicion të dhënat, aktualisht nuk i kam me vete, por mund t'jua vë në dispozicion.

Nasip Naço – Faleminderit!

(Diskutim pa mikrofon)

Adea Pirdeni – Për ta saktësuar, meqenëse marrëveshja akoma nuk është në fuqi, kjo do të thotë që shtetasit e shqiptarë nuk mund të ekstradohen drejt Spanjës dhe anasjelltas. Pra, kërkesat për ekstradim nuk mund të pranohen deri në momentin që kjo marrëveshje ratifikohet nga të dyja shtetet.

Nasip Naço – Faleminderit!

Fjala për zotin Çelaj.

Isuf Çelaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetja ime është: a ka ndonjë strategji qeveria për të gjetur instrumente të tjera ligjore më efikase për të luftuar krimin e eksportuar jashtë vendit, që të mos vijë dita dhe të bëjmë të njëjtën marrëveshje edhe me Ekuadorin, ku kohët e fundit krimi shqiptar është rritur në përmasat shqetësuese? Sipas medieve deri tani janë vrarë 6 shtetas shqiptarë.

Nuk ka dyshim që këtë marrëveshje e ka iniciuar qeveria spanjolle, pyetja ime është: qeveria shqiptare do të jetë gjithmonë në pozita pritëse?

E fundit, a do të marrë qeveria shqiptare nismë për një marrëveshje ekstradimi me Emiratet e Bashkuara Arabe, me të cilën ekstradimet kanë dështuar për shumë trafikantë shqiptarë, ku kanë gjetur si strehë Dubain?

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Çela!

Fjala për ju zonja Pirdeni.

Adea Pirdeni – Lidhur me pyetjen për sa i përket një strategjie për instrumente të tjera ligjore në luftën kundër krimit, aktualisht në tërësinë e marrëveshjeve, ku Ministria e Drejtësisë është autoritet qendror dhe monitorues hetimi dhe për më tepër kur është palë në këto procese, ne kemi një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh dypalëshe dhe shumëpalëshe për bashkëpunim gjyqësor në fushën ndërkombëtare penale. Natyrisht që është pjesë integrale e të gjitha politikave qeveritare dhe politikave kundër krimit që të intensifikohet lufta kundër krimit transnacional, si një nga format ku shfaqet në mënyrë të dukshme, për shembull, në pastrimin e produkteve të veprës penal ose vepra të tjera që i kalojnë kufijtë e një shteti.

Në këtë kuadër janë marrë një sërë iniciativash ligjore vitet e fundit, mund t’u referohem iniciativave ligjore që janë marrë në kuadër të paketës kundër pastrimit të parave, në kuadër të ICRG-së dhe FATF-së për të ndërmarrë një sërë iniciativash, të cilat synojnë parandalimin e krimit transnacional në fushën pastrimit të produkteve të veprës penale.

Ministria e Drejtësisë nuk ndodhet gjithmonë në kondita pritëse, këtu për t’ju përgjigjur pyetjes tuaj. Në fakt, dua të bëj një lidhje të pyetjes së dytë me të tretë, sepse në rastin e Emirateve është bërë një kërkesë zyrtare e nga Ministria e Drejtësisë për të nisur procesin e negociimit për një marrëveshje me Emiratet. Kjo do të thotë që nuk jemi në pozita pritëse, por përkundrazi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rasti i parë, por është rast për t’u përmendur. Edhe në vijim të shqetësimit që keni ngritur, ky shqetësim është konsideruar në mënyrë tërësore nga Ministria e Drejtësisë dhe ky proces ka iniciuar dhe do të vijojë rrugëtimin e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Çela!

Fjalën e ka zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo marrëveshje nuk bën gjë tjetër, për interes të shtetit spanjoll, vetëm krijon një lloj lehtësie për ta. Për shembull, një shtetas spanjoll që ka kryer veprën penale në Spanjë, pas kryerjes së veprës penale vjen në Shqipëri me idenë për t’ju fshehur drejtësisë. Për këtë arsye unë dua të di, a ka pasur pranë Ministrisë së Drejtësisë, kërkesa nga shteti spanjoll drejtuar shtetit shqiptar, për transferimin e procedimit penal apo kërkesa për ekzekutimin e vendimeve penale spanjolle për t’u

ekzekutuar në Shqipëri? Pra për ata shtetas që kërkojnë ekstradimin. Nuk e di nëse është e qartë apo jo? Nëse ka sa janë?

Adea Pirdeni – Kërkesë për transferimin e procedimit penal nga pala spanjole nuk ka asnjë, ka vetëm një kërkesë të transferimit të procedimit penal nga pala shqiptare, e cila është bërë në vitin 2020 dhe është kërkuar për veprën penale të mashtrimit.

Për sa i përket ekzekutimit të vendimeve penale nuk ka asnjë kërkesë.

Enkelejd Alibeaj – Pra ju thoni që shteti spanjoll nuk ka sjellë asnjë procedim penal nga Spanja në Shqipëri, aty ku ndodhet personi që ata kërkojnë ta ekstradojnë, jo vetëm kaq, por nuk ka as vendime për t'u ekzekutuar, pyetja ime është: përse po kërkojnë ata ekstradimin? Ata nuk kanë asnjë interes, sepse nuk ka pasur një procedim, nuk ka pasur një vendim dhënë në Spanjë atëherë nuk ka asnjë interes për të kërkuar ekstradimin e një shqiptari atje. A mund të më thoni arsyen, motivet?

Të them edhe diçka, sepse është e natyrës politike. Sigurisht që marrëveshjet me një shtet duhet të lidhen, por ama motivet se nga niset procesi i lidhjes së një marrëveshje duhet të dihet, sepse janë të natyrës politike dhe atë vlerëson Kuvendi. Pra këtë duhet të dimë ne.

Faleminderit!

Adea Pirdeni – Faleminderit, edhe ju për pyetjen!

Nëse i referohem institutit të ekstradimit dhe institutit të transferimit të procedimit, janë dy institute të ndryshme. Kjo do të thotë se nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me njëra me tjetrën, pra kanë qëllime të ndryshme. Instituti i ekstradimit kërkon në thelb që nëse një person, sikurse ju e thatë, që ka kryer veprën penale në Spanjë dhe është larguar nga Spanja dhe gjendet në Shqipëri kërkohet që ky person të ekstradohet drejt Spanjës në mënyrë që ai t'i nënshtrohet procesit, të ushtrohet ndjekja penale, të zbatohet një masë sigurie e kështu me radhë. Ndërsa transferimi i procedimit penal, sigurisht ka të bëjë me faktin kur një shtet transferon të gjithë procedimin që ai të kryhet në vendin tjetër, ku ndodhet personi në mënyrë që të vijohet të ushtrohet ndjekja penale e kështu me radhë. Pra në rastin konkret kemi të bëjmë me dy vendimmarrje të natyrave të ndryshme, me dy institute totalisht të ndryshme. Natyrisht, çdo shtet vlerëson se cili do të jetë mekanizmi i duhur, i nevojshëm dhe më i përshtatshëm ndoshta dhe sipas rastit, kjo në varësi të veprës penale që mund të jetë objekt shqyrtimi nga pala spanjolle në këtë rast ose pala shqiptare.

Nasip Naço – Po, zoti Alibeaj, por të vendosim një rregull që të bëjmë pyetjet, të marrim përgjigjet dhe pastaj të kalojmë në diskutime. Të mos e kthejmë në intervistë, t’i bëjmë të gjitha pyetjet dhe pastaj të vazhdojmë...

Enkelejd Alibeaj – Atë po bëj, po bëj pyetje për të kuptuar. Përsëri unë ngulmoj, zonjusha zëvendësministre, se çfarë është transferimi i procedimit apo ekzekutimi i vendimit penal dhe ekstradimi, besoj se po të njëjtat leksione kemi lexuar ju edhe unë, modestish, për ta kuptuar ju, por edhe publiku.

Vepra penale kryhet në Spanjë nga një shtetas shqiptar, dakord, ka shumë të paudhë që bëjnë prapësi. Pra, ka kryer veprën penale në Spanjë dhe ka ardhur në Shqipëri. Është e qartë se do t’i shpëtojë drejtësisë spanjolle. Shteti spanjoll në çdo rast fillon procedimin penal, nuk ka se si të ndodhë ndryshe. Fillon procedimin penal për veprën penale, ndërkohë shqiptari i dyshuar ka ardhur në Shqipëri me shpresën që atje vazhdon procedimin penal, por në Shqipëri është i sigurt. Ka dy mënyra, ose procedimi shkon tek i pandehuri, ky është transferimi për ta kuptuar njerëzit, nuk ka nevojë për të na e thënë edhe një herë në Komision të Sigurisë, pra ose transferimi vjen tek i pandehuri, “mali te Muhameti”, ose i pandehuri merret dhe çohet te procedimi, “Muhameti te mali”.

Nasip Naço – Zoti Alibeaj, cila është pyetja?

Enkelejd Alibeaj – Ja, këtë po them tani.

Nasip Naço – Jo, se po bëni leksion dhe këtu nuk jemi për leksion.

Enkelejd Alibeaj – Zoti kryetar, a mund ta çoj deri në fund, sepse dua të jem i qartë për të kuptuar. Edhe zëvendësministrja kur tund kokën, besoj se e kupton.

Nasip Naço – Jo, se ajo është e zonja dhe përgjigjet. Ajo e di edhe transferimin, edhe ekstradimin, edhe njohjen e vendimit...

Enkelejd Alibeaj – Një sekondë, se unë po pyes këtu për statistikë. Statistika është e thjeshtë për të kuptuar motivet.

Nasip Naço – Po bëj pyetjet dhe lëri diskutimet.

Enkelejd Alibeaj – Po më lini ta bëj.

Nasip Naço – Ju lutem, lërin diskutimet dhe vazhdoni me pyetjet.

Enkelejd Alibeaj – Sa kërkesa para këtij momenti, sepse nuk e kemi lidhur këtë marrëveshje akoma, ka për transferim nga Spanja në Shqipëri ka? Pra, sa kërkesa kanë ata për

shtetasit shqiptarë që janë këtu? Nëse janë zero, siç ju thatë, atëherë ata nuk kanë asnjë procedim penal, pra nuk kanë nevojë, sepse nuk kanë proceduar asnjë.

Që ta çoj deri në fund, me gjithë buzëqeshjen tuaj, nevoja për ekstradimin e një shtetasi shqiptar nga Shqipëria në Spanjë lind kur mekanizmi i transferimit të procedimit nuk funksionon dhe, e dyta, sepse nuk kanë besim te drejtësia shqiptare.

Cila është nga të dyja?

Besoj se e kuptuat tani.

Ka një motiv të deklaruar, apo jo?

Adea Pirdeni – Kam përshtypjen se iu përgjigja kësaj pyetjeje kur ju shtruar pyetjen e parë, që nuk ka asnjë kërkesë për transferim të procedimit penal. Natyrisht, është në vlerësim të vetë shtetit të vendosë, në diskrecion të të gjitha autoriteteve të palës spanjolle, nëse do t'i transferojnë procedimet apo do të vijojnë me procedimin penal duke kërkuar ekstradimin e personave. Pra, është në vlerësimin e plotë të autoriteteve. Arsyet se pse zgjidhet një mekanizëm ose një tjetër janë në vlerësim të atij shteti.

Nasip Naço – Më mirëkupto, zoti Alibeaj, nuk kam asgjë me pyetjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Pyetja është pyetje, komenti është koment dhe diskutim.

Unë dua të ndaj pyetjen dhe më pas diskutimin ...

Enkelejd Alibeaj – Kam një parashtresë, për ta kuptuar.

Nasip Naço – Në rregull.

Ju erdhët me pak vonesë, por zonja u përgjigj.

Edhe për 25 rastet që janë kërkuar për këtu, edhe 3 nga ana jonë, por erdhët me vonesë dhe nuk e morët informacionin e duhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, nga Komisioni i Ligjeve dhe këtu.

Nuk kam gjë për pyetjen, pasi është pyetja juaj, por do të doja që pyetjet për zonjushën dhe zotërinë që kanë ardhur, të bëhen në lidhje me projektin që kemi përpara, të vazhdojmë me diskutimet dhe më pas je i lirë të diskutosh dhe të komentosh.

A ka pyetje nga kolegët e tjerë para se të kalojmë te diskutimet?

Faleminderit!

Kalojmë te pika e dytë e diskutimeve.

Zoti Salianji.

Ervin Salianji – Edhe një herë tjetër, çdo marrëveshje e ardhur së fundi nga shtetet e Bashkimit Europian, tregon qartë se gjendja e sigurisë, rritja e nivelit të kriminalitetit në Shqipëri dhe jo vetëm kaq, por ashtu siç citohet në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit: Shqipëria është kthyer në një qendër operationale për trafikun e drogave të forta; Shqipëria është vendburim dhe prodhuesja kryesore, për fat të keq, e kanabisit në Europë; elementi kriminal dhe krimi i organizuar në Shqipëri është fuqizuar aq shumë, sa tentakulat apo të gjithë rrjetin e vet e ka të shpërndarë pothuajse në të gjitha vendet e Bashkimit Europian, në vendet e Amerikës Latine, siç e tha kolegu pak më parë. Të gjitha shtetet që kërkojnë takim me Kryeministrin e Shqipërisë në Europë e detyrojnë të firmosë një marrëveshje vetëm për këtë punë, duke pasur si kryefjalë luftën ndaj krimit dhe korrupsionit. Në këto marrëveshje kërkohet të bëhet e mundur që elementi kriminal, i cili kryen vepra penale, në këtë rast, në territorin e Spanjës, të mos gjejë strehim në Shqipëri, sepse, siç e thatë edhe ju, që ta kuptonte edhe publiku, 25 prej tyre, në mos gaboj, kanë kryer vepra penale në shtetin e Spanjës dhe kanë kërkuar t'i kthejnë atje, por ndërkohë janë të lirë këtu. Kemi dëgjuar shumë raste mediatike të tilla, si në Durrës, pak kohë më parë, që nuk ekstradohen, sepse përdoren. Këta janë elementet dhe kontingjenti kryesor, sikur u bëhet nder nga qeveria shqiptare, për t'i përdorur në zgjedhje. Këta janë kontingjenti dhe mbledhësit kryesor të votave në çdo lagje, në çdo fshat për Partinë Socialiste, sepse qeveria ua shet si nder personal, duke i mbajtur këtu, pavarësisht se kanë kryer vepra penale në vendet e BE-së dhe duhet të ishin në burg. Nuk janë të izoluar, por janë në krye të punëve të Rilindjes dhe të shtabeve të deputetëve të Partisë Socialiste.

Ky është thelbi i diskutimit. Këto janë arsytet politike pse e ka kërkuar qeveria e Spanjës. Këto janë arsytet pse po na vijnë përjavshëm marrëveshje të tilla nga të gjitha vendet e BE-së dhe janë një kampion alarmi për cilindo në këtë vend, se qeveria dhe maxhoranca nuk do të dëgjojë, por përpiqet ta kalojë me teknikalitete; nuk do ta njohë gjendjen e kriminalitetit dhe jo më ta luftojë për rritjen e sigurisë publike, ku, siç duket edhe këtu, e tha drejtori i Përgjithshëm i Policisë kur ishte, që vrasjet nga krimi i organizuar janë shumëfishuar, tritoli kërcet në mes të qyteteve, vrasjet kryhen në mes të qytetit dhe autorët nuk zbulohen, sepse ka sofistikim të krimit dhe rrjet gjithandej. Qeveria jo vetëm është dorëzuar, por i është dorëzuar dhe ia ka dorëzuar sovranitetin në shumë prej territoreve mafies.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Salianji!

Zoti Alibeaj, për diskutim.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, më duhet të them që në fillim se ne do ta votojmë këtë marrëveshje, e cila nuk është e para, faktikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të gëzoheni edhe për shumë gjëra të tjera.

Ajo që do të them më pas nuk është lajm i mirë për ju dhe për maxhorancën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse nuk është marrëveshja e parë, pasi ka marrëveshje të tjera me këtë lloj përmbajtjeje, të cilat shteti shqiptar i ka ratifikuar. Por ka një lajm të keq. Cili është lajmi i keq?

Shteti spanjoll ka kërkuar lidhjen e kësaj marrëveshjeje duke u nisur nga një motiv i thjeshtë, të paktën kjo ka dalë nga diskutimet këtu dhe në Komisionin e Ligjeve, megjithëse unë ia kam kërkuar me ngulm përfaqësuesve të qeverisë, që shteti spanjoll nuk beson te qeveria shqiptare, te policia shqiptare dhe te sistemi i drejtësisë. Për këto arsye, ata kërkojnë që të pandehurit shqiptarë, që kanë kryer vepra penale në Spanjë, t'i marrin dhe t'i gjykojnë atje. Ky është qëllimi i marrëveshjes. Pra, t'i çojnë para prokurorisë dhe gjykatave spanjolle. Ky është lajm i keq, sepse në një situatë tjetër normale, nëse policia shqiptare, shteti shqiptar dhe sistemi gjyqësor shqiptar do të funksiononte, shteti spanjoll nuk do ta kishte aspak problem që procedimin penal, të cilin do ta zhvillonte në Spanjë, ta transferonte në Shqipëri, te partnerët e besueshëm gjyqësor dhe policorë shqiptarë, dhe të mos kishte asnjë merak, sepse drejtësia do të ishte njësoi si në Spanjë edhe në Shqipëri. Ky është lajmi i keq.

Po, është e vërtetë, dikur qeveria shqiptare ka lidhur një marrëveshje me Italinë, ka qenë e para me të njëjtën përmbajtje, shumë kohë më parë, por po në atë kohë pranohej qartësisht se drejtësia shqiptare ishte difektoze. Ky ishte motivi i parë.

Së dyti, këto janë marrëveshje atipike, nuk lidhen shpesh.

Duke iu referuar marrëveshjeve të mëparshme, të lidhura nga shteti shqiptar, në kohën kur Partia Socialiste nuk ka qenë në maxhorancë, është deklaruar qartësisht motivi se përse lidheshin marrëveshje të tilla, saktësisht, marrëveshja është lidhur me Italinë ndaj një shërbimi që i bëhej shtetit italian në atë kohë, pra në raporte partneriteti dhe barazie, i është kërkuar shtetit italian në atë kohë për këtë favor që Shqipëria po i bënte, të investonte në Shqipëri. Në atë kohë është lidhur,

me të drejtë, në pozita partneriteti. Shteti italian ka investuar për ndërtimin e një burgu, një ndihmë ndaj sistemit të drejtësisë. Kjo është e ndershme, sepse ruan fytyrën e shtetit shqiptar dhe rrit bashkëpunimin.

Ndërkohë, e kam kërkuar me ngulm dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje: çfarë kemi kërkuar ne ndaj shtetit spanjoll për këtë favor që po iu bëjmë, sepse kërkesën e kanë bërë ata? Nëse nuk deklarohet, të paktën, a nuk ishte detyrim moral i shtetit shqiptar, i qeverisë shqiptare, që teksa po i bënim këtë favor Spanjës, të kërkonin minimalisht një gjë të thjeshtë, që shteti spanjoll të njihnte pavarësinë e Kosovës, sepse nuk e ka njohur?! Kështu negociohet në marrëdhëniet ndërkombëtare. Po, ne i japim një porcion të vogël të sovranit, siç e tha zoti Salianji, shumë mirë, por kemi detyrimin moral dhe kushtetues të kërkonim prej tyre të njihnin pavarësinë e Kosovës, sepse është një nga shtetet që ende nuk e ka njohur. Kjo do të ishte, besoj unë, një justifikim i ndershëm në marrëveshje të tilla. Ndërkohë, kokë ulur, pa asnjë motiv të deklaruar, shpresoj të mos ketë ndonjë motiv të kamufluar, pak besim kam, por dyshoj që mund të ketë diçka të tillë, të jepet një koncesion i tillë.

Edhe një herë, unë dhe grupi parlamentar jemi pro marrëveshjeve të tilla edhe për një arsye fare të thjeshtë: për sa kohë që dështon drejtësia shqiptare, absolutisht do të kërkojmë ndihmën e vendeve të tjera. Kam përshtypjen se është shumë mirë që për fenomenin e korrupsionit dhe për autorët e dyshuar të korrupsionit qeveritar në këtë vend është mirë të mos ketë vende, ku ne të mos kemi marrëveshje të tilla ekstradimi. Gjithmonë bregu i fundit i qeveritarëve të korruptuar, akti i fundit që bëjnë, është pikërisht të kërkojnë se ku ka vende që nuk kanë marrëveshje ekstradimi me Shqipërinë.

Unë e uroj dhe e nxis qeverinë shqiptare të lidhë marrëveshje ekstradimi me çdo shtet që ende nuk e kemi lidhur. Ky do të ishte një shërbim i mirë dhe po jua them që e keni mbështetjen tonë që në këto momente, në mënyrë që për të gjithë ata qeveritarë të korruptuar, ende të paproceduar, por do të vijë gjithmonë koha, të procedohen, pavarësisht skepticizmit që kemi ndaj sistemit të drejtësisë. Është mirë të mos ketë asnjë ishull ku të mund të strehohen ndaj përndjekjes penale që mund të ndodhë.

Faleminderit për kohën, mundësinë, pyetjet dhe diskutimin!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Alibeaj, që ju, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, u dhatë një lajm të mirë shqiptarëve, që do ta miratoni këtë marrëveshje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, lajm i keq është për skifterët shqiptarë, që janë në çdo vend tjetër të botës, por aq më keq, në Spanjë. Po i quaj skifterë, për ta kuptuar edhe qytetarët, që me miratimin e kësaj marrëveshjeje, nëse kryejnë një veprë penale në Spanjë dhe strehohen në Shqipëri, me kërkesë të autoriteteve gjyqësore spanjolle do të ekstradohen në Spanjë.

Shqipëria dhe qeveria tregojnë një vullnet të qartë, ndryshe nga ato që parashtruat ju, se do ta luftojnë krimin dhe do të japin një mesazh për të gjitha qeveritë dhe të gjithë skifterët shqiptarë, që nuk do të jetë strehë e krimit.

Për faktin që erdhi sot me kërkesë të Spanjës, historia e shtetit shqiptar nuk fillon me Partinë Demokratike apo me Partinë Socialiste. Marrëdhëniet e ekstradimit datojnë hershëm, në vitin 1927 me Mbretërinë e Bashkuar të Anglisë, në vitin 1935 me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vitin 1935 me Çekinë, duke vazhduar me Europën Lindore, me Traktatin e Varshavës në atë kohë. Po ashtu, kemi kaluar edhe atë që ju thatë në vitin 2013 me Italinë, me Kosovën, me Maqedoninë në vitin 1998, para se ta bënit edhe ju. Pra, janë disa marrëveshje për ekstradimin, ku qeveritë, në kohë të ndryshme, kanë treguar vullnet për të luftuar krimin dhe nuk ka të bëjë me atë që ju pretendoni.

Për sa i përket sugjerimit që i bëni Ministrisë së Drejtësisë, edhe unë do të bëj të njëjtën gjë, i inkurajoj të sjellin edhe marrëveshje të tjera.

Për pjesën e korrupsionit, për ta kuptuar edhe qytetarët shqiptarë, nëse një qytetar shqiptar kryhen një veprë penale apo korrupsion dhe strehohet në një vend tjetër, nuk ka të bëjë me ekstradimin.

Ti e kupton shumë mirë. Edhe kolegët e tjerë e kuptojnë shumë mirë që në këtë rast nuk ka të bëjë me ekstradimin, por në çdo vend që të jetë, nëse ka një procedim në Shqipëri, me kërkesë edhe nga Interpoli, edhe me kërkesë nga marrëveshje të tjera të Europolit, vjen në Shqipëri. Kjo nuk ka të bëjë me ekstradimin. Me ekstradimin ka të bëjë vetëm në rast se kryhen një veprë penale në Spanjë dhe strehohet në Shqipëri dhe nëse një shtetas spanjoll kryhen një veprë penale në Shqipëri dhe strehohet në Spanjë. Kaq, është shumë e thjeshtë për ta kuptuar dhe për të hequr pjesën e politikës.

Unë do të doja t'ju falënderoja edhe një herë që jeni në një gjatësi vale me vullnetin e qeverisë dhe do ta votoni këtë marrëveshje!

Do t'i ftoj të gjithë kolegët për ta votuar dhe mbështetur. Besoj se nëse nuk ka diskutime të tjera, ta hedhim në votim.

Faleminderit!

Hedhim në votim në parim “Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Europiane, për ekstradimet e viteve 1957”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kush është dakord me nenin 1 të kësaj marrëveshjeje? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi për “Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës, si shtesë e Konventës Europiane, për ekstradimet e viteve 1957”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Zoti Çelaj, nuk kam mbaruar.

Kemi mbaruar me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

I falënderoj dhe inkurajoj të sjellin marrëveshje të tjera!

Për kolegët e tjerë deputetë, dje kemi lënë si pikë të dytë raportin apo vizitën që kemi bërë në Kosovë.

Jeni të interesuar të vazhdojmë apo ta lëmë një ditë tjetër. Jepni mendimin tuaj.

Zoti Xhaferraj nuk është i pranishëm, prandaj mendoj ta lëmë për një seancë tjetër.

Faleminderit për vëmendjen, vullnetin dhe mbështetjen!

MBYLLET MBLEDHJA